

## **DOKUMENTET DHE PROCEDURA E PRANIMIT NË PROGRAMET MASTER I SHKENCAVE**

---

Në mënyrë që të pranohen në Master i Shkencave, kandidatët duhet të plotësojnë këto dokumente:

- Formularin e interesimit (shkarkohet online)
- Kopjen e noterizuar të diplomave të ciklit të parë të parë që studenti ka fituar.
- CV-në e kandidatit, ku të paraqiten të dhëna biografike dhe të eksperiencave profesionale.
- Një Letër Interesi (afërsisht 500 fjalë) ku të paraqiten objektivat profesionale, interesat kërkimore dhe nxitjet për të kryer studimet e ciklit të dytë.
- Një projekt-ide ku të paraqiten interesat e tij shkencore gjatë programit.
- Dy Letra Rekomandimi të cilat garantojnë kompetencën profesionale, përgatitjen akademike dhe mundësinë e kandidatit për të kryer studimet në këtë nivel.
- Paraqitja e një dokumenti që tregon aftësitë e kandidatit në njohjen e një gjuhe të huaj përbën një avantazh.

### **Procedura e Pranimi**

Të gjitha dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen në Zyrën e Kontratave. Pas vlerësimit formal të listës së dokumenteve të nevojshme, dokumentacioni i kalon Departamentit përkatës, i cili bën vlerësimin e aplikimeve dhe harton listën e kandidatëve të përzgjedhur. Çdo kandidat i përzgjedhur zhvillon një intervistë me Komitetin Shkencor të programit rreth projektit të zhvillimit të karrierës, në përputhje me fushën e studimit.

Kur Rektori e sheh të arsyeshme ngarkon Fakultetet të organizojnë zhvillimin e një *IQ test* dhe/ose testi seleksionimi. Në këtë rast pranohen ata kandidatë që kalojnë testin e zhvilluar nga Komisioni i veçantë.